


# Qëndrimet e KDI-së

## për projektligjin e Këshillit Prokurorial të Kosovës







Instituti Demokratik I Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e  
zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse  
dhe luftës kundër korrupsion përmes  
promovimit të transparencës,  
llogaridhënies dhe integritetit në të  
gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2023. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239  
10 000, Prishtinë, Kosovë.

Tel: +383 (0) 38 248 038

E-mail: [info@kdi-kosova.org](mailto:info@kdi-kosova.org)

Ueb: [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Layout and design: **envinion**

"Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit "EU4 Rule of Law: Citizen Engagement for Public Integrity (CEPI) in the Western Balkans and Turkey", që financohet nga Bashkimi Evropian".



Funded by  
the European Union

# PËRMBAJTJA

**06**

QËNDRIMET E KDI-SË PËR  
PROJEKTLIGJIN E KËSHILLIT  
PROKURORIAL TË KOSOVËS

**07**

1. RUAJTJA E BALANCIT MES  
ANËTARËVE PROKURORË  
DHE JO PROKURORË

**08**

2. STANDARDI I DYFISHTË I  
PROCEDURËS SË  
RI-EMËRIMIT TË ANËTARËVE

**09**

3. PËRFSHIRJA (JO KUSHTETUESE)  
E AVOKATIT TË POPULLIT NË  
PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE JO  
PROKURORË

**10**

4. MUNGESA E AFATIT LIGJOR PËR  
DEKRETIMIN E KRYEPROKURORIT  
TË SHTETIT

**12**

REKOMANDIME



# Qëndrimet e KDI-së për Projektligjin e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Në gusht të vitit 2021 Qeveria e Kosovës, miratoi Strategjinë për Sundim të Ligjit, e cila ishte derivat i procesit të Rishikimit Funkcional të Sundimit të Ligjit në Kosovë. Strategjia në fjalë theksoi nevojën për reformimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, veçanërisht reformën në Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Një projektligj për plotësim-ndryshimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial u propozua nga Ministria e Drejtësisë i cili parashihte shkurtimin para kohe të mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit Prokurorial, rritjen e numrit të anëtarëve jo prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi, si dhe përfshirjen e Avokatit të Popullit drejtpërdrejtë në përzgjedhjen e anëtarëve jo prokurorë. Ky projektligj para se të miratohet në Kuvend ishte dërguar për vlerësim në Komisionin e Venecias, i cili në mars të vitit 2022 kishte ofruar vlerësimin përkrahës që ekziston nevoja për reformë në Këshillin Prokurorial të Kosovës.<sup>1</sup>

Kuvendi i Kosovës në Qershor të vitit 2022 miratoi në lexim të dytë projektligjin për ndryshim-plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial. Projektligji që parashikonte shkurtimin e parakohshëm të mandatit për anëtarët e KPK-së, kishte pësuar ndryshim sa i përket përbërjes së KPK-së dhe zgjedhjes së anëtarëve jo prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi. Kështu, Projektligji u plotësua me propozimin që për një periudhë të përkohshme, KPK-së t'i shtohen edhe 8 anëtarë jo prokurorë deri në janar të vitit 2026. Me gjithë propozimet në fjalë, ky projektligj u anulua nga Gjykata Kushtetuese pas kontestimit të tij nga partitë opozitare në Kosovë. Sipas vendimit të Kushtetueses, ligji bie ndesh me nenet e Kushtetutës për Formën e Qeverisjes dhe Ndarjen e Pushtetit, Kompetencat e Kuvendit, Rolin e Avokatit të Popullit, Barazinë para Ligjit.<sup>2</sup>

Pas këtij vendimi të Kushtetueses, më 12 korrik të vitit 2023, Qeveria miratoi "versionin e ri" të Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, sipas ndryshimeve të bëra nga Ministria e Drejtësisë. Kryetari i Kuvendit Glauk Konjufca

pak ditë pasi që projektligji u dorëzua në Kuvend, kërkoi përsëri një opinion nga Komisioni i Venecias për projektligjin në tërësi. Në dhjetor të vitit 2023, Komisioni i Venecias, publikoi opinionin e dytë duke sqaruar që nuk mbështetë rritjen e numrit të anëtarëve të KPK në 19 anëtarë, po ashtu duke paraqitur edhe vërejtje mbi përfshirjen e Avokatit të Popullit në përzgjedhjen e anëtarëve jo prokurorë, si dhe për rrezikun e ndikimit politik në Këshillin Prokurorial nëpërmjet përzgjedhjes së anëtarëve jo prokurorë me shumicë të thjeshtë të votave në Kuvend.

Mirëpo, pavarësisht këtij opinioni, verzioni i ri i Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili është miratuar në lexim të parë më 8 mars 2024 nga Kuvendi i Kosovës, ka mangësi kushtetuese dhe nuk adreson mjaftueshëm kërkesat e Gjykatës Kushtetuese të nxjerrë sipas vendimit të datës 5 prill 2023 dhe as vërejtjet e Komisionit të Venecias mbi çështjet që përfshin ruajtjen e balancit mes anëtarëve prokuror dhe jo prokuror.

Për më tepër, projektligji nuk garanton pavarësinë kushtetuese të Këshillit Prokurorial nga ndikimi politik për shkak të propozimit për emërim të tetë anëtarëve jo prokurorë me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, gjithashtu parashihet rolin e Avokatit të Popullit në propozimin e anëtarëve jo prokurorë në Kuvend nga shoqëria civile. Madje, i njëjti nuk rregullon **afatet se kur duhet të vendos institucioni i Presidentit mbi dekretimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit**. Si dhe ka nevojë të përfshijë në mënyrë të qartë kriterin që anëtari jo prokurorë në Këshillin Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile, duhet të jetë personi që është aktivisht pjesë e shoqërisë civile dhe jo vetëm faktin që të propozohet një kandidat nga disa organizata të shoqërisë civile.

1 Shih Komisioni i Venecias, opinion nr.1080.2022, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2022\)006-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2022)006-e), publikuar më 18-19 mars 2022.

2 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, vendim në rastin KI 100/22 dhe KI 101/22, mars 2023.





# 1. Ruajtja e balancit mes anëtarëve prokurorë dhe jo prokurorë

**Problemi:** Projektligji i propozuar parasheh që përpos (11) anëtarëve aktual, deri në vitin 2026 - KPK-së t'i shtohen edhe 8 anëtar jo prokuror, të zgjedhur nga Kuvendi. Nëse të gjithë këta anëtarë të rinj arrijnë të zgjedhën përnjëherë, kjo do të kishte ndikim në kuorumin dhe vendimmarrjen e KPK-së. Sipas draftit të propozuar, kuorumi i mbledhjeve dhe vendimmarrja në Këshill deri në vitin 2026 do të mundësohej me prezencën e vetëm 12 nga 19 anëtarët e tij.

Vërehet qartë nga ky përcaktim i propozuar në ligj do të fuqizonte në mënyrë asimetrike anëtarët jo prokurorë, meqë do t'i bënte ata faktorë vendimtarë në funksionimin dhe vendimmarrjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës, që bie ndesh me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 5 prill 2023.

Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese është kërkuar që anëtarët jo prokurorë që zgjedhën nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë të votave, të mos jenë faktor vendimtar në funksionimin e KPK-së e madje të mos jenë faktor bllokues të punës dhe aktiviteteve të KPK-së, që ka të bëjë me kryerjen e funksioneve kushtetuese të garantuara nga Kushtetuta për KPK-në, si institucion plotësisht i pavarur kushtetues.

Një zgjidhje e tillë, duket së është parë problematike edhe nga Komisioni i Venecias, i cili për këtë çështje vlerësoi që ekziston rrezik i konsiderueshëm i bllokimit të punës së KPK-së, nëse anëtarët jo prokurorë të emëruar nga Kuvendi zgjedhin të mos marrin pjesë në mbledhje, duke paralizuar kështu veprimtarinë e KPK-së.<sup>3</sup>

**Propozimi:** Prandaj, sa i përket përbërjes së Këshillit prokurorial të Kosovës, të merret për bazë rekomandimi i Komisionit të Venecias që përbërja në Këshill të formohet me 7 anëtarë. Katër anëtarë prokuror dhe 3 anëtarë jo prokuror. Nga radhët e anëtarëve jo prokurorë të propozohet përbërja me një anëtarë nga fakulteti juridik, një anëtarë nga shoqëria civile dhe një anëtarë nga Akademia e Drejtësisë.

Madje, për të reduktuar mundësinë e bllokimit të tillë të punës së KPK-së, në linjë me mendimin e Komisionit të Venecias rekomandohet që ligji të parashikojë masa disiplinore më të rrepta dhe efektive për mospjesëmarrje efektive të anëtarëve jo prokurorë në aktivitetet e KPK-së pa arsyetim të vlefshëm.

<sup>3</sup> Komisioni i Venecias, opinion nr. 1149/2023, datë 18 dhjetor 2023.





## 2. Standardi i dyfishtë i procedurës së ri-emërimit të anëtarëve

**Problemi:** Projektligji i propozuar përmban disa dispozita kalimtare ligjore shqetësuese për faktin se përmbajnë standard të dyfishtë mbi të drejtën e rizgjedhjes së anëtarëve të KPK-së. Konkretisht, neni 21, paragrafët 4, 5 dhe 6 nuk ofrojnë standard të njëjtë të së drejtës për tu rizgjedhur në Këshill me mandat të plotë si për anëtarët aktual të këshillit -- *ashu edhe për anëtarët jo prokuror që pritet të emërohen nga Kuvendi pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.*

Përderisa në parim, në paragrafin 4 të neni 21 përcaktohet që anëtarët prokurorë të Këshillit përfshirë kryesuesin dhe zëvendësuesin e KPK-së mund të qëndrojnë në detyrë deri në skadimin e plotë të mandatit të tyre, në paragrafin 5 të këtij neni specifikohet që në rast se ndonjëri prej tyre jep dorëheqje ose largohet nga ushtrimi i mandatit para kohe, caktimi dhe zëvendësimi i tij me kandidatin e ri do të bëhet vetëm për dy vite, pra, deri në janar 2026 por i njëjti nuk do të ketë të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat të plotë.<sup>4</sup>

Mirëpo, pavarësisht kësaj, duket se projektligji i ri, nuk ka ndjekur standardin e njëjtë dhe ka privilegjuar anëtarët jo prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi sa i përket vazhdimin e mandatit dhe të së drejtës për tu riemëruar. Kështu, në paragrafin 6 të neni 21, ku është në pyetje emërimi i 8 anëtarëve të rinjë jo prokurorë në Këshill pas hyrjes në fuqi të këtij projektligji përcaktohet që këta anëtarë jo prokurorë edhe pse emërohen me mandat të përkohshëm deri në janar të vitit 2026, ata të njëjtit do ta kenë mundësinë që të rizgjidhen përsëri për të fituar pastaj mandatin e plotë.<sup>5</sup>

Me një fjalë, përderisa anëtarët prokuror të zgjedhur në Këshill pas largimit nga detyra nuk do të shërbejnë në Këshill me mandat të plotë por vetëm përkohësisht deri në janar 2026, për anëtarët jo prokuror të zgjedhur të zgjedhur nga Kuvendi, do t'ju jepet mundësia që të fitojnë të drejtën për tu riemëruar edhe me një mandat të plotë që mund të

fitohet pas vitit 2026 ani pse të njëjtit fillimisht zgjidhen përkohësisht deri në vitin 2026.

Sipas opinionit të Komisionit të Venecias, dispozitat kalimtare të propozuara ngrenë shqetësime serioze për sa i përket përputhshmërisë së tyre me standardet ndërkombëtare dhe evropiane: ato rrisin në mënyrë efektive rrezikun e politizimit, krijojnë kushte të pafavorshme për stabilitetin institucional dhe efikasitetin operacional, të një organi kushtetues si KPK dhe mund të perceptohet nga mazhoranca e ardhshme si një mundësi për të ushtruar ndikimin e tyre politik në KPK duke rritur numrin e anëtarëve pas çdo zgjedhjeje të ardhshme.<sup>6</sup>

**Propozimi:** Të fshihen dispozitat kalimtare të këtij projektligji që parashikojnë mundësinë e rizgjedhjes me mandat të plotë për anëtarët jo prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë të votave. Kjo ngase do të rriste rrezikun që pas kalimit të periudhës së përkohshme, pra janar 2026, të njëjtit të marrin mandat 5 vjeçar, dhe kjo nënkupton se ata mund të qëndrojnë në këtë pozitë për shtatë vite rresht. Prandaj, përcaktimet ligjore të tilla të ofruara nga këto dispozita kalimtare bie ndesh me vet dispozitat e këtij Ligji sepse qartazi Ligji thotë që mandati i anëtarëve të Këshillit Prokurorial është pesë vite pa mundësi rizgjedhjeje.

4 Shih për më tepër paragrafi 5 i neni 21 të Projektligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

5 Sipas paragrafit 6 të neni 21 të Ligjit të propozuar të KPK-së thuhet që: Pavarësisht paragrafit 1 të Neni 12 të ligjit bazik, anëtari i Këshillit që zgjedhet sipas paragrafit 2 ose 5 të këtij neni, mund të zgjedhet edhe për një mandat të plotë si anëtar i Këshillit, që zbatohet pas datës 11 janar 2026.

6 Komisioni i Venecias, Opinion nr.1149/2023, datë 18 dhjetor 2023.







# 3. Përfshirja (Jo kushtetuese) e Avokatit të Popullit në përzgjedhjen e anëtarëve jo prokurorë

**Problemi:** Projektligji i propozuar për KPK-në, përsëri parasheh që institucioni i Avokatit të Popullit të ketë të drejtën që të ofrojë dy propozime për anëtar jo-prokuror të cilët do të veprojnë si përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Pra, në kundërshtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në rastin KO100/22 dhe KO101/22, projektligji i ri jep Avokatit të Popullit, të drejtën që të propozojë dy anëtarë jo prokuror nga radhët e shoqërisë civile të cilët pastaj do të zgjedhën nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë të votave.<sup>7</sup>

Duhet theksuar që Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Avokatin e Popullit nuk përcakton asnjë të drejtë për institucionin e Avokatit të Popullit që të organizojë ose zhvillojë procedura rekrutimi për emërim të anëtarëve në institucioneve publike, e aq më pak të drejtën që të ofroj propozime të kandidatëve për pozita dhe përfaqësim në institucione publike në emër dhe llogari të organizatave tjera, në këtë rast caktimin e një anëtari nga Shoqëria Civile.<sup>8</sup>

Për më tepër, Kushtetuta në nenin 65 paragrafi 10, përcakton që Kuvendi i Kosovës është institucioni i vetëm që përzgjedhë anëtarët e Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Kosovës.

Në anën tjetër, Komisioni i Venecias rreth çështjes së përfshirjes së Avokatit të Popullit në procedurën e propozimit e të përzgjedhjes së anëtarëve jo prokurorë të Këshillit nga radhët e shoqërisë civile, theksoi rrezikun që cilësia e kandidatëve dhe neutraliteti i tyre politik do të varret në masë të madhe nga propozimet e organizatave të shoqërisë civile në përputhje me kërkesat ligjore të vendosura nga Kuvendi.

Megjithatë, sipas mendimit të Komisionit, pavarësisht që Avokati i Popullit mund të jetë në gjendje të zgjedhë dy kandidatët më të mirë, që do të thotë se ai/ajo mund të përjashtojë kandidatët që ai/ajo i konsideron të papërshtatshëm ose të lidhur politikisht.<sup>9</sup> Por, ekziston një lloj tensioni mes rrezikut që roli i Avokatit të Popullit mund të cenohet kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët jo prokurorë dhe në anën tjetër, nevojës për një kontribut të fuqishëm të tij për të parandaluar rrezikun e politizimit të Këshillit që mund të rrjedh nga përzgjedhja e anëtarëve jo prokurorë me votën e shumicës së thjeshtë në Kuvend. Si rrjedhojë, Komisioni i Venecias konstatoi që zgjidhja aktuale është e pamjaftueshme për të kompensuar rrezikun e politizimit në zgjedhjen e anëtarit jo prokurorë me propozimin apo emërimin nëpërmjet Avokatit të Popullit.

**Propozimi:** Duke marrë për bazë vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, dhe Komisionit të Venecias, institucioni i Avokatit të Popullit nuk duhet të përfshihet fare në asnjë lloj mënyre apo formati në procedurën e emërimit të anëtarëve jo prokurorë të Këshillit. Për më tepër, projektligji gjatë plotësimit ndryshimit, duhet të specifikojë qartë që anëtari nga radhët e shoqërisë civile, duhet të jetë gjithnjë personi i cili është pjesëtar aktiv i shoqërisë civile në momentin e përzgjedhjes. Pra, dispozita e nenit 9 paragrafi 3.3 përpos propozimit që i njëjti anëtarë të emërohet nga një konkurs publik, i shpallur nga Kuvendi dhe i propozuar nga së paku 5 organizata, të plotësohet një kriter që kandidati që përzgjidhet për këtë pozitë të jetë pjesëtarë aktiv dhe i punësuar në ndonjërin nga organizatat e shoqërisë civile.

<sup>7</sup> Për më tepër shih: Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Aktgjykim në rastin KO.100/22 datë 5 prill 2023. Sipas aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese theksohet që duhet pasur kujdesë që kompetencat e Këshillit Prokurorial në vendimmarrje assesi të mos diktohen nga një ose dy vota të anëtarëve jo prokuror të zgjedhur nga Kuvendi.

<sup>8</sup> Po ashtu, në këtë aktgjykim, Gjykata Kushtetuese por edhe Komisioni i Venecias e kanë parë si problematik faktin që avokati i popullit të infiltrrohet në procedura të përzgjedhjes së anëtarëve jo prokuror në KPK.

<sup>9</sup> Shih, Komisioni i Venecias, Opinion nr.1149/2023, datë 18 dhjetor 2023, faqe 9. Sipas mendimit të Komisionit, ekziston një tension ndërmjet kërkesës kushtetuese që roli i Ombudspersonit nuk duhet të cenohet kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët jo prokurorë dhe nevojës për një kontribut të fuqishëm të Avokatit të Popullit për të kompensuar rrezikun e politizimit që rrjedhin nga vota e shumicës së thjeshtë në Kuvend. Si pasojë, zgjidhja aktuale është e pamjaftueshme për të kompensuar rrezikun e politizimit në zgjedhjen e anëtarit jo prokurorë me emërimin e Avokatit të Popullit.





# 4. Mungesa e afatit ligjor për dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit

**Problemi:** Emërimi i pozitës së Kryeprokurorit të Shtetit në Kosovë ka kohë që është bërë problematike e madje është shoqëruar me procedura zvarritëse, të tejzgjatura dhe me shumë kritika si nga organizatat ndërkombëtare ashtu edhe vendore. Madje, sipas vlerësimit të disa OJQ-ve, procesi i përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit nuk ka siguruar meritokraci, objektivitet dhe se kandidatët nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë, dhe se tërë këtij procesi i ka munguar integriteti dhe është shoqëruar me shkelje të shumta të procedurave ligjore.<sup>10</sup>

Reagime të tilla pati edhe nga Ambasada Amerikane në Prishtinë si dhe Zyra e Bashkimit Evropian, të cilët procesin në fjalë të organizuar nga KPK e cilësuan si jo transparent, jo meritokraci dhe që minoi besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.<sup>11</sup>

Megjithatë, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës është organ kompetent për të propozuar kandidatin për Kryeprokuror të Shtetit tek Presidenti i Republikës, i cili me dekret vendos për emërimin e tij. Kushtetuta, ndonëse e shpjegon procedurën se si bëhet emërimi i Kryeprokurorit, nuk përcakton ndonjë afat që detyron Presidentin të vendos për dekretimin apo jo të një kandidati për Kryeprokuror të Shtetit.<sup>12</sup> Për pasojë, rastet në praktikë kanë dëshmuar se proceset e dekretimit të kryeprokurorit janë zvarritur me muaj, madje edhe me vite. Konkretisht, dekretimi i ish-Kryeprokurorit Aleksandër Lumezi kishte marrë kohë për më tepër se 1 vit, ndërsa aktualisht për kandidatin e propozuar Blerim Isufaj kishin kaluar më tepër se një vit që kur Presidentja Osmani njoftoi se nuk do të vendos për dekretim të tij.<sup>13</sup>

---

<sup>10</sup> Për më tepër shih: Betimi për Drejtësi, Prill 2023, <https://betimiperdrejtesi.com/shala-procesi-i-perzgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit-u-shoqerua-me-parregullsi-te-shumta/> (qasur më 18 mars 2024).

<sup>11</sup> Ekonomia Online, <https://ekonomia.info/sq/politike/shba-dhe-be-kritikojne-menyren-e-perzgjedhjes-se-kryeprokurorit-te-shtetit> (qasur më 18 mars 2024).

<sup>12</sup> Shih: Kushtetuta e Kosovës, kapitulli për Prokurorinë e Shtetit, neni 109.

<sup>13</sup> Kushtetuta e Kosovës, kompetencat e Presidentit, neni 84, 85, 86.





Meqë përpos Kushtetutës, edhe ligjet përkatëse si Ligji i Këshillit Prokurorial, Ligji për Prokurorin e Shtetit dhe Ligji për Presidentin, nuk përcaktojnë ndonjë afat kohor se kur Presidenti/ja dekretin një kandidat për Kryeprokuror të Shtetit si dhe nuk definojnë procedurën se si duhet vepruar nëse i/e njëjta refuzon dekretimin e kandidatit të propozuar, kjo pozitë kaq e rëndësishme po vazhdon që dy vite të mbahet me një ushtrues detyre.

**Propozimi:** Pavarësisht që Kushtetuta nuk i ka dhënë ndonjë afat Presidentit për dekretimin e prokurorit të Shtetit, verzioni aktual i Ligjit për Këshillin Prokurorial ka përcaktuar një afat 60 ditor në bazë të së cilit Presidenti/ja duhet t'i dekretojë Prokurorët e rinj.<sup>14</sup> i njëjti përcaktim ekziston edhe në Ligjin për Këshillin Gjyqësor ku theksohet afati i njëjti për dekretimin e gjyqtarëve nga Presidenti/ja.

Duke marrë për bazë analogjinë e njëjtë dhe me qëllim të spikatjes së rëndësisë për përcaktimin në Ligj të afatit që duhet të veprojë Presidenti/ja i shtetit për dekretimin kandidatit për kryeprokuror shtetit pas propozimit nga ana e Këshillit Prokurorial, duhet që në Ligjin e Ri për KPK-në, të përcaktohet afati prej **60 ose 90 ditësh** nga dita e Propozimit nga ana e KPK, që Presidenti/ja të vendos për dekretimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit.<sup>15</sup>

Po ashtu, është tejet e rëndësishme që të përcaktohet edhe procedura e veprimit në rastet kur Presidenti/ja nuk dekretin një kandidat për pozitën e tillë brenda afatit në fjalë. Me një fjalë, duhet të parashikohet mundësia e njëjtë siç është me rastin e propozimeve për prokuror të rinjë, ku Ligji për Këshillin Prokurorial përcakton qartë që nëse brenda afatit prej (60) ditësh Presidenti nuk e emëron prokurorin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar, dhe pas kësaj Presidenti emëron prokurorin sipas propozimit të Këshillit.

Në fund, duhet theksuar që Ligji në fjalë, e parashikon të njëjtën procedurë edhe për situatën kur propozohet shkarkimi i ndonjë prokurori dhe se do të ishte e duhur që analogjia e njëjtë të përdoret edhe për rastet që do të përfshinin propozimin për shkarkimin e kryeprokurorit të shtetit.<sup>16</sup>

14 Shih neni 23 i Ligjit për Këshillin Prokurorial: Presidenti emëron dhe riemëron prokurorët bazuar në propozimet e Këshillit. Presidenti, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e prokurorit të kandidatit të propozuar nga Këshilli. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e emëron prokurorin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti emëron prokurorin sipas propozimit të Këshillit.

15 KDI, gjatë angazhimit në grupin punues për Ligjin e Prokurorit të Shtetit në Kuvend, ka propozuar që kjo çështje të përfshihet në këtë projektligj, megjithatë anëtarët e grupit punues në mënyrë unanime kanë vendosur që këtë çështje t'a trajtojnë në kuadër të Ligjit për KPK-në, pasi që Këshilli është organ që propozon kandidatin për Kryeprokuror dhe aty duhet të vendoset afati në fjalë.

16 Ligji për Këshillin Prokurorial në nenin 25 paragrafi 6 përcakton që: Presidenti, brenda tridhjetë (30) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për shkarkimin e prokurorit të propozuar nga Këshilli. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e shkarkon prokurorin, Këshilli paraqet edhe një herë propozimin për shkarkimin e prokurorit së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti shkarkon prokurorin sipas propozimit të Këshillit.



# REKOMANDIME

**Përfundimisht bazuar edhe në rekomandimet e Komisionit të Venecias por edhe në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese projektligji i Këshillit Prokurorial të Kosovës duhet të plotësohet me këto propozime shtesë:**

- 1** Lidhur me përbërjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës, të merret për bazë rekomandimi i Komisionit të Venecias që përbërja në Këshill të formohet me 7 anëtarë. Katër anëtarë prokuror dhe 3 anëtarë jo prokuror. Nga radhët e anëtareve jo prokurorë të shikohet mundësia që të propozohet përbërja nga anëtarët jo prokuror me një anëtarë nga fakulteti juridik, një anëtarë nga shoqëria civile dhe një anëtarë nga Akademia e Drejtësisë.
- 2** Për të reduktuar mundësinë e bllokimit të funksionimit të Këshillit Prokurorial, në linjë me mendimin e Komisionit të Venecias rekomandohet që projektligji të parashikojë masa disiplinore më të rrepta dhe efektive për mospjesëmarrje efektive në mbledhje të anëtarëve jo prokurorë pa arsyetim të vlefshëm.
- 3** Të fshihen dispozitat kalimtare të këtij projektligji që parashikojnë mundësinë e rizgjedhjes me mandat të plotë për anëtarët jo prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë të votave. Kjo ngase do të rriste rrezikun që pas kalimit të periudhës së përkohshme, pra janar 2026, të njëjtit të marrin mandat 5 vjeçar, dhe kjo nënkupton se ata mund të qëndrojnë në këtë pozitë për shtatë vite rresht. Prandaj, përcaktimet ligjore të tilla të ofruara nga këto dispozita kalimtare bie ndesh me vet dispozitat e këtij Ligji sepse qartazi Ligji thotë që mandati i anëtarëve të Këshillit Prokurorial është pesë vite pa mundësi rizgjedhjeje.
- 4** Duke marrë për bazë vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese, dhe Komisionit të Venecias, institucioni i Avokatit të Popullit nuk duhet të përfshihet fare në asnjë lloj mënyre apo formati në procedurën e emërimit të anëtarëve jo prokurorë të Këshillit.
- 5** Ligji të përcaktojë një afat kohor konkret sipas të cilit Presidenti/ja i vendit duhet të vendosë për dekretimin apo mos dekretimin e kandidatit për kryeprokuror të shtetit.

Dispozita konkrete eventuale do të mund të parashihej si në vijim:

- 1** "Kryeprokurori i Shtetit emërohet dhe shkarkohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, në bazë të propozimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Mandati i Kryeprokurorit të Shtetit është shtatëvjeçarë, pa mundësi riemërimi.

*Presidenti, brenda gjashtëdhjetë (60), apo (90) ditësh, pas pranimit të propozimit, nxjerr dekret për emërimin në detyrën e Kryeprokurorit të kandidatit të propozuar nga Këshilli. Nëse brenda këtij afati Presidenti nuk e emëron Kryeprokurorin, Këshilli mund ta paraqesë edhe një herë tjetër kandidatin e propozuar së bashku me arsyetimin plotësues në formë të shkruar. Pas kësaj Presidenti emëron Kryeprokurorin sipas propozimit të Këshillit."*

Procedura e njëjtë të vlejë edhe në rastet e procedurës për shkarkim të Kryeprokurorit të Shtetit.

- 6** Të ndryshohet dispozita e nenit 9 paragrafi 3.3 i ligjit për KPK-në, ku përpos kriterëve që theksojnë se anëtari nga shoqëria civile të emërohet nga një konkurs publik, i shpallur nga Kuvendi dhe i propozuar nga së paku 5 organizata, të plotësohet me një kriter shtesë që kandidati që përzgjidhet për këtë pozitë nga shoqëria civile të jetë pjesëtarë aktiv dhe i punësuar në ndonjërin nga organizatat e shoqërisë civile.

